



**Penn Alexander Shkolla Fillore
2021-2022 Procesi i Regjistrimit të Kopshte**

Më poshtë janë udhëzimet dhe afatet kohore që do të rregullojnë mënyrën se si do të kryhet procesi i aplikimit dhe zgjedhjes për të regjistruar studentët në klasat e Kopshteve të Shkollës Fillore Penn Alexander (PAS) për vitin shkollor 2021-2022. **Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen përmes sistemit të regjistrimit online.**

Procesi i llotarisë së Kopshtit të Penn Alexander / Kronologjia	
Datat e Regjistrimit	E Hënë, 19 janar 2021 deri të Premten, 5 shkurt 2021
Personeli i shkollës dërgon listën përfundimtare OSEP përmes emailit.	E Premte, 10 Shkurt 2021
Drejtoria Arsimore përpunon aplikacionet	15 Shkurt 2021 - 19 Shkurt 2021
Letrat e lotarisë që dërgohen në shtëpitë e studentëve:	E Premte, 26 Shkurt 2021

Udhëzime të Përgjithshme

- Vetëm fëmijët që banojnë brenda zonës PAS kanë të drejtë për llotari. Të gjitha aplikimet e marra pas mbylljes së periudhës së regjistrimit të Kopshtit do të vendosen në një listë pritjeje dhe nuk do të merren parasysh në procesin e llotarisë. Aplikimet do të caktohen në listën e pritjes në mënyrë që ato të merren duke filluar me numrin e parë pas studentëve të llotarisë. Aplikimet konsiderohen të plota pasi të jenë shënuar të plota nga sekretaria e shkollës.
- Dy dokumente që konfirmojnë vendbanimin brenda zonës kërkohen me dorëzimin e materialeve të regjistrimit si: një dokument që është një Deed, një dokument i noterizuar për qiranë, faturë e shërbimeve ose informacion i lëshuar nga qeveria. Faturat e ujit, Residency affidavits dhe Delegations of Parental Responsibility NUK do të pranohen. I gjithë informacioni përfshirë imunizimet DUHET të paraqitet për shqyrtim. Të gjitha aplikacionet që plotësojnë kërkesat e vendbanimit do të vendosen në një llotari.
- Ky njoftim do të rishikohet çdo vit dhe do të vendoset në faqen e internetit të Drejtorisë Arsimore kur Drejtoria Arsimore shpall regjistrimin për Kopshtin e fëmijëve në ose para 11 Janarit. Të gjitha njoftimet do të përkthehen në tetë gjuhët kryesore të Drejtorisë.
- Të gjitha format e regjistrimit duhet të dorëzohen në PAS në ose para afatit të fundit. Sistemi nuk do të marrë më aplikime në 11:59 PM(mesnatë) të Premten, 5 Shkurt 2021.
- Të gjitha vendimet e regjistrimit do të komunikohen vetëm me shkrim përmes postës elektronike(email) në adresën e postës elektronike(email) të përdorur gjatë plotësimit të aplikimit. Vendimet e regjistrimit nuk do të komunikohen përmes telefonit dhe as nuk do t'u jepen letra prindërve nga Shkolla Penn Alexander ose Education Center e Drejtorisë Arsimore..
- Për më shumë informacion mbi procesin e regjistrimit në internet, ju lutemi vizitoni www.philasd.org/studentplacement/registration



**Penn Alexande r Shkolla Fillore
2021-2022 Procesi i Regjistrimit të Kopshte**

Dëshmi e Adresës

Dëshmi e Adresës (Kërkohen Dy (2) nga sa vijon)

Dokumentacioni i pranueshëm përfshin dokumentat e listuar më poshtë: Njëri nga dokumentat duhet të jetë Deed (akt),dokument i noterizuar për qiranë ose faturë e shërbimeve. Të gjitha informacionet e vendbanimit do të verifikohen për saktësi. Mund të kërkohen informacione shtesë gjatë procesit të verifikimit.

Deed (Dokumenti tregon që je pronar i shtëpisë)	Karta e identifikimit e vlefshme DOT
Mortgage settlement sheet(dokument mortgage)	Fatura aktuale e credit card
Fatura aktuale e shërbimeve (gaz, elektrik)	Regjistrimi aktual i automjetit
Fatura aktuale e taksës së pronës	Karta e regjistrimit të votimit që tregon adresën aktuale
Patentë shoferi e vlefshme, ose ndryshimi i kartës së adresës me adresën tuaj aktuale	Deklarata e fundit e bankës me adresën aktuale
Letër nga Zyra e Sigurimeve Shoqërore me adresën aktuale	Deklarata IRS ose deklarata të tjera të pagave dhe taksave p.sh., W2, 1040, 1099
Letër nga Zyra e Ndihmës Publike me adresën aktuale	Çeqet e fundit, që tregojnë adresën aktuale
Kujdesi për fëmijë / letrat DHS janë të pranueshme për regjistrim kur një student është në kujdesin e një agjencie kujdestare / të kujdesit për fëmijë	Kontratë origjinale e qirasë me emrin(emrat) e prindërve/kujdestarët ligjorë dhe emrat e fëmijëve
Marrëveshja e nënshkruar e shitjes së pronës e shoqëruar nga kopja origjinale e letrave të vendimit brenda 45 ditëve kalendarike të vendimit	